

OSSH Sh.A

RELACIONI TEKNIK

“RIKONSTRUKSION I RRJETIT TM/TU PER FIDERAT NGJEQAR,
ROSKOVEC 3, STRUM 4, N/ST. MATKE 35/10 KV”

DREJTORIA RAJONALE FIER
4-15-2026

RELACION

Emri i plote i OBJEKTIT te investimit:

Rikonstrukcion i rrjetit TM-TU per fiderat Ngjeqar, Roskovec 3, Strum 4, NSt. Matke 35-10 kV

1. Hyrje

Bazë Ligjore dhe Rregullatore: Në mbështetje të **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016**, “Për miratimin e rregullores së projektimit, zbatimit dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit”, konkretisht **nenit 55**, “Shërbimet në planifikimin e sistemeve teknike”, përcaktohet se fazat e projektimit duhet të bazohen në strukturimin e qartë të dokumenteve teknike, përfshirë:

- **Detyrën e Projektimit,**
- **Projekt–Idenë**

si dhe kërkesat specifike për zhvillimin e secilës fazë.

Fazat e Punës dhe Gjendja Aktualisht: Në zbatim të përcaktimeve të mësipërme:

- Është **“Detyra së Projektimit”**, e cila do të shërbejë si kërkesa për nisjen dhe përgatitjen e projektit te investimit.
- është **“Projekt–Idea”**, si faza për zgjidhjen teknike dhe vlerësimin paraprak të projektit te investimit.

Ky relacion ka për qëllim paraqitjen e kërkesave, detyres së projektimit dhe projekt-idese për realizimin e një sistemi shpërndarjeje elektrike konform Kodit të shpërndarjes. Projekti synon sigurimin e furnizimit të qendrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike për konsumatorët, duke respektuar standardet teknike

Relacion përshkruan hapat teknike, verifikimet dhe dokumentacionin e nevojshëm për zgjidhjen e problematikave dhe nevojave të zhvillimit në zonat përkatëse.

2. Kërkesat

- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët.
- Respektimi i standardeve teknike dhe normave të sigurisë elektrike.
- Ulja e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.
- Zgjerimi i rrjetit

Detyra e Projektimit

Objekti i detyrës së projektimit është të përcaktojë me saktësi kufijtë orientues dhe kriteret funksionale që do të shërbejnë si bazë orientuese për grupin projektues në hartimin dhe dimensionimin e projektit të përmirësimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelet TM dhe TU. Ky objektiv përfshin analizën e detajuar të gjendjes ekzistuese të rrjetit në zonat e furnizuara nga fiderat me performancë të dobët, duke identifikuar segmentet kritike që ndikojnë në besueshmërinë, kapacitetin transmetues dhe cilësinë e tensionit.

Në kuadër të kësaj detyre, përcaktohen:

- Parametrat teknikë sic janë rëniet e tensionit, ngarkesat maksimale dhe minimale, kapacitetet termike të përçuesve, nivelet e mbrojtjes dhe selektivitetit, kufijtë e stabilitetit të rrjetit.
- Udhëzimet topologjike mbi të cilat do të strukturohet skema e re ose e përmirësuar e furnizimit në TM dhe TU.
- Kriteret e optimizimit të rrjetit, përfshirë reduktimin e humbjeve teknike, rritjen e fleksibilitetit operativ, dhe rritjen e reziliencës kundrejt avarive.
- Zonat me prioritet ndërhyrjeje, të identifikuar përmes analizave të ngarkesës, matjeve në terren, statistikave të avarive dhe performancës së fiderave.
- Kërkesat për rritjen e kapaciteteve, si rezultat i zgjerimit urban, shtimit të konsumit dhe integritit të burimeve të shpërndara të energjisë (nëse ka).

Vendosja e këtyre piketave synon sigurimin e një baze të standardizuar teknike që mundëson hartimin e një projekti inxhinierik të qëndrueshëm, të optimizuar dhe të përputhshëm me kodin e rrjetit të shpërndarjes. Përmes këtij procesi, sigurohet që zgjidhjet e propozuara të adresojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse problemet e fiderave ekzistues, të përmirësojnë cilësinë e furnizimit dhe të garantojnë funksionimin afatgjatë, të sigurt dhe efikas të rrjetit.

- **Analiza e gjendjes aktuale të rrjetit elektrik në zonë.**


Gjendja aktuale e infrastruktures elektrike të zonës (në rrjetin shpërndarës të TM dhe TU) nuk i përgjigjet ritmit dhe zhvillimit urbanistik të zonës. Pjesë të këtij rrjeti paraqiten jashtë kushteve teknike dhe me mbingarkesa të pa lejuara, gjë që sjell kufizime dhe cilësi poshtë standardeve të kërkuara në furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të kësaj zone.

Ky projekt përfshin të gjithë zonën e Bashkisë Roskovec të furnizuar nga N/St. 35/10 kV Matkë. Zonë e cila përbëhet nga të paktën 25648 banorë.

Të gjitha zonat e tjera përceç qytetit, karakterizohen nga një terren kryesisht kodrinor-malor, me lartësi të ndryshme dhe shtrirje të fragmentuar, ku zonat e banuara shtrihen përgjatë ultësirave të ngushta dhe rrugëve lidhëse që ndjekin relievin natyror. Toka është e përzier mes sipërfaqeve bujqësore dhe zonave të thepisura, me vendbanime të shpërndara dhe infrastrukturë lineare që ndjek drejtimet natyrore të luginave.

Projekti përfshin një zonë gjeografike prej rreth 63 km² dhe një numër total prej rreth 4429 abonente (familjare dhe private).

Vendos një harte-imazh të zones



Zona Gjeografike e Ngjeqan

FIDERAT EKZISTUES

N/stacioni 35/6kV Pocem															
Fideri	Tensioni	Fuqia instaluar max.	Fuqia e gjeneruesve	Abonent		Linja TM				Nr. nderprerjeve	Kohe zgjatja (min)	Humbje teknike (kWh)	Humbje teknike %	Humbje jo teknike (kWh)	Humbje jo teknike %
						Linja	Gjatesi	Seksioni							
Nr.	(kV)	(kVA)	(kVA)	N/stacion	Fider	(model)	(km)	(mm ²)	Viti 2025	Viti 2025					
Fratar	6	5,448	0	Pocem	1,631	Ajrore	66.7	Al-Ç 50-25	153	102	19713	97749	24%	N/A	N/A
Kute	6	2,485	0	Pocem	580	Ajrore	22.6	Al-Ç 35-16	151	78	14181	35064	17%	N/A	N/A
Pocem	6	520	0	Pocem	21	Ajrore	1.1	Al-Ç 50-25	62	15	256	7758	15%	N/A	N/A
Klos	6	3,295	0	Pocem	582	Ajrore	18.1	Al-Ç 35	140	65	864	45629	25%	N/A	N/A
Freskia	6	430	0	Pocem	45	Ajrore	0.55	Al-Ç 35-25	57	12	150	1335	5%	N/A	N/A
Totali	6	12.178	0	Pocem	2.859	Ajrore	109.05					187535	17%		

KABINAT EKZISTUESE

Kabinat e evidentuara, të instaluara në fiderat e dale nga N/St. 35/10 kV Matkë, paraqesin një infrastrukturë të larmishme si nga tipi konstruktiv (shtylllore, murature, metalike), ashtu edhe nga kapacitetet e instaluara dhe numri i abonentëve. Shumica e daljeve janë të realizuara me përçues bakri CU 4x16 deri 4x50 mm², çka tregon se rrjeti ekzistues i tensionit të ulët është pjesërisht i amortizuar, me përçues me kapacitete të kufizuara dhe shpesh të papërshtatshëm për ngarkesat aktuale dhe ato të pritshme.

Në të gjithë fiderat e përmendur në tabelën e mësipërme do të bëhen ndërhyrjet përkatëse në përmirësimet e rrjetit TM-kabina elektrike dhe rrjeti TU. Tet re fiderat e përfshirë në këtë investim karakterizohen nga një gjatësi e madhe dhe relativisht numër të lartë abonentësh, si i tillë paraqesin risk më të lartë për rënie tensioni, mbingarkesa në dalje dhe humbje teknike të rritura, sidomos kur daljet janë të zgjatura dhe shtrihen në terren kodrinor-malor. Kabinat shtyllore, të cilat dominojnë në disa zona, zakonisht kanë kufizime në mbrojtje, ventilim, aksesim dhe kapacitet për zgjerim. Nga ana tjetër, kapacitetet e ndryshme të transformatorëve (50–320 kVA) nuk përputhen gjithmonë me ngarkesën reale, duke sjellë situata si mbingarkesa sezonale ose përdorim e duhur të transformimit.

Të gjitha këto elementë tregojnë nevojën për një projekt të ri të TU, i cili të përfshijë rikonfigurim të daljeve, rritje të seksioneve të përçuesve, ndarje të ngarkesave, standardizim të paneleve të mbrojtjes dhe optimizim të menaxhimit të tensionit, me qëllim rritjen e besueshmërisë, uljen e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit për zonat përkatëse.

- Kabinat ekzistuese në këto zona janë të tipit:
 - o Murature
 - o Shtyllore

LINJAT TM EKZISTUESE

Rrjeti i mesëm të tensionit (TM) që furnizon kabinat e listuara shtrihet në zona me relief kryesisht kodrinor–malor, me linja ajrore 10 kV që ndjekin korridore të gjata dhe shpesh të thyer në drejtim të zonave periferike të Bashkisë Patos, karakterizohen nga trasa të zgjatura, me drejtim radial dhe me degëzime të shumta, çka krijon kufizime në stabilitetin e tensionit dhe rrit ndjeshmërinë e rrjetit ndaj defekteve atmosferike dhe avarive.


Shtrirja e rrjetit TM në këto zona përfshin poste transformimi të shpërndara në distanca të mëdha nga njëra-tjetra, të vendosura në pika të terrenit ku kërkesa për energji është e fragmentuar dhe ku linjat kalojnë nëpër zona të vështira për mirëmbajtje. Projekti sjell përmirësimin e performancës së këtyre kabinave në përmirësimin e profilit të tensionit, reduktimin e gjatësive të tepërta të daljeve, rritjen e fleksibilitetit operativ përmes degëzimeve të reja ose rikonfigurimit të rrjetit, si dhe krijimin e kushteve për shpërndarje më të qëndrueshme dhe efikase në zonat e thella rurale. Rrjeti ekzistues kërkon ndërhyrje për shkak të ngarkesave të shpërndara, zhvillimit të vendbanimeve dhe distancave të gjata nga nënstacionet furnizuese, duke bërë të domosdoshëm investimin për të garantuar një furnizim të sigurt dhe cilësor.

Me poshte është pershkrimi për gjendjen ekzistuese të rrjetit TM për zonën që do të kryhet investimi, projekti i ri dhe materialet që do të përdoren për zbatimin e projektit dhe llogaritjet teknike.

- Skema ekzistuese ku do të investohet

N / STACIONI 35 / 10 KV - MATKE


Fidri 3 - RROSKOVEC




Panel 1 - NOJEGAR

• ndryshuar

- ## Pamje nga linat dhe Robinat ekzistuese





Me poshte po paraqesim te dhenat e fiderave dhe kabinave ekzistuese

- Te dhenat e rrjetit

Fideri	Ten sioni	Fuqia inst aluar max.	Fuqia e gjene ruesve	Abonent		Linja TM						Nr. nde rpr erjeve	Kohe zgjatja	Humbje totale (kWh)	Humbje	Humbje jo teknike (kWh)	Humbje jo teknike %
						Totale %											
						Linja	Gjat esi Linje	Seks ioni	Ngarkesa pik. (A)			Viti 2025					
Nr.	(kV)	(kVA)	(kVA)	N/sta cion	Fider	(model)	(km)	(mm²)	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025						
Fideri 1 - Ngjeqar	10	5448	0	Matke	1240	Ajrore	30.3	AlÇ 95-16	189	n/a	n/a	54	10713	104445	32%	n/a	n/a
Fideri 3 - Roskovec	10	2485	0	Matke	2018	Ajrore	7.36	AlÇ 95-16	119	n/a	n/a	72	1328	97528	15%	n/a	n/a
Fideri 4 - Strum	10	520	0	Matke	1171	Ajrore	11.5	AlÇ 95-16	121	n/a	n/a	81	14011	33241	10%	n/a	n/a
TOTALI	6	8453		Matke	4429	Ajrore	49.16	AlÇ 95-16	429	n/a	n/a			235214	17%	n/a	n/a

- Humbjet totale e rrjetit ekzistues:

Nr.	Emri N/St	Izolacioni	Nr. Fiderit	Kabina	Nr. Abonenteve	Humbjet
		kV				%
1	Matke	35/10	Roskoveci 3	20	1,240	32%
2			Strum 4	30	2,018	15%
3			Ngjeqar	18	1,171	10%
TOTALI				68	4,429	19%

- Performanca e rrjetit ekzistues

Nr.	Emri N/St	Izolacioni	Nr. Fiderit	Viti	
		kV		Nr. nderprerjeve	Kohe zgjatja
1	Matke	35/10	Roskoveci 3	54	10713
2			Strum 4	72	1328
3			Ngjeqar	81	14011

- Skema ekzistuese e fiderave ku do te investohet

Duke qënë se në këtë investim nuk janë parashikuar ndërtim kabina të reja, skema e fiderave përkatës është e pa ndryshueshme.

PROJEKT-IDE

1. Domosdoshmeria, arsyeja e kryerjes se investimit

Ky investim bazuar dhe ne detyren e projektimit eshte planifikuar te kryhet keto arsye:

Për një furnizim sa më të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike të zonës së Ngjeqa, Struk dhe Roskovecit dhe zonave përreth

1. Amortizimi i rrjetit ekzistues TU

Rrjeti aktual i tensionit të ulët përbëhet kryesisht nga përçues të zhveshur, të instaluar prej shumë vitesh dhe të ekspozuar ndaj kushteve të vështira atmosferike. Degradimi fizik i përçuesve, izolatorëve dhe elementëve mbështetës ka ulur ndjeshëm sigurinë dhe efikasitetin e furnizimit, duke e bërë të domosdoshëm rikonstruksionin.

2. Humbje të larta teknike dhe rënie tensioni

Daljet e gjata dhe seksionet e vogla të përçuesve ekzistues shkaktojnë rënie të konsiderueshme të tensionit, sidomos në skajet e largëta të linjave, si dhe rritje të humbjeve teknike. Instalimi i kabllave ABC me seksione të përshtatura për ngarkesën përmirëson profilin e tensionit dhe ul ndjeshëm humbjet.

3. Ngarkesë e shpërndarë dhe rritje e konsumit

Zonat Ngjeqan, Struk, Roskovec dhe rrethinat kanë zhvillim të shpërndarë të banesave dhe kërkesa në rritje për energji elektrike (bujtina, agroushqimor). Kapaciteti i daljes aktuale nuk është më i mjaftueshëm për të përballuar kërkesat e reja, prandaj rikonstruksioni i rrjetit TU është i domosdoshëm për të garantuar furnizim cilësor dhe të pandërprerë.

4. Rritja e defekteve për shkak të kontaktit me bimësinë

Përçuesit e zhveshur aktualë janë të ekspozuar ndaj kontaktit me degët e pemëve, sidomos në terrenin kodrinor-malor ku pemët rriten pranë linjave. Ky kontakt shkakton ndërprerje të shpeshta dhe avari sezonale. Kalimi në kabllot ABC me izolim të plotë eliminon këtë problem.

5. Siguri e ulët operationale dhe rrezik ndaj njerëzve dhe kafshëve

Përçuesit e zhveshur përbëjnë rrezik të lartë të goditjes elektrike, veçanërisht në zonat rurale ku linjat kalojnë pranë banesave apo sipërfaqeve të punuara. Kabllot ABC rrisin sigurinë falë izolimit të plotë dhe zvogëlojnë ndjeshëm rrezikun e aksidenteve.

6. Vështirësi në mirëmbajtje dhe akses në terren

Rrjeti aktual, për shkak të konfigurimit të vjetër dhe trasesë së vështirë, kërkon kohë dhe kosto të lartë për çdo ndërhyrje. Instalimi i ABC siguron linja më të qëndrueshme, me defekte shumë më të pakta dhe me kërkesë më të ulët për ndërhyrje korrigjuese.


7. Standardizimi i infrastrukturës sipas kërkesave aktuale

Rikonstruksioni lejon standardizimin e daljes nga kabinat, përfshirë seksionet e përçuesve, shtyllat, pajisjet mbrojtëse dhe pajisjet e ndarjes. Ky proces përmirëson performancën e rrjetit dhe e përgatit zonën për zgjerime të ardhshme.

8. Përmirësimi i cilësisë së furnizimit për konsumatorët

Qëllimi i investimit është të sigurojë tension të stabilizuar, reduktim të ndërprerjeve dhe rritje të besueshmërisë së energjisë në familje, biznese dhe shërbime publike. Kalimi në ABC dhe rikonfigurimi i rrjetit TU sjell një cilësi më të lartë furnizimi në mënyrë të qëndrueshme.

- Planimetri gjeografike ku do të shtrihet investimi:



Zona gjeografike e cila preket nga investimi

Qëllimi i këtij investimi është përmirësimi i sigurisë, besueshmërisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike në zonat e mbuluara nga kabinat e fiderat e n/st Matke dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Ky investim synon të:

- eliminojë rëniet e tensionit dhe humbjet teknike të shkaktuara nga gjatësia e madhe e linjave dhe seksionet e pamjaftueshme;
- rrisë reziliencën e rrjetit ndaj defekteve atmosferike dhe kontaktit me bimësinë;
- standardizojë daljet TU sipas kërkesave teknike aktuale;
- sigurojë mbrojtje më të lartë ndaj aksidenteve elektrike në zonat rurale; dhe
- krijojë kapacitete të mjaftueshme për rritjen e ngarkesës dhe zhvillimin e mëtejshëm të komuniteteve lokale..

2. Variantet e Propozuara PER PROJEKTIN E RI

Variant 1

Rikonstruksion rrjeti TU me kablllo me vetëmbajtje ABC

Propozimi për investimin konsiston në rikonstruksionin e plotë të rrjetit ekzistues të tensionit të ulët (TU) në zonat e furnizuara nga kabinat e listuara, duke përdorur kablllo ajrore me vetëmbajtje (ABC – Aerial Bundled Cable) si të vetmen zgjidhje teknike të përshtatshme. Ky variant paraqitet si alternativë unike për shkak të kushteve të veçanta të terrenit, ndarje të ngarkesave, shtrirjes së vendbanimeve dhe problematikave të rrjetit aktual.

Rrjeti aktual TU, kryesisht i përbërë nga përçues të zhveshur, paraqet një shkallë të lartë amortizimi, humbesh teknike dhe defektesh të shpeshta, veçanërisht në zona të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe kontaktit me bimësinë. Duke qenë se këto kabina shtrihen në zona të thella rurale, ku linjat TU janë të zgjatura dhe kalojnë në terren kodrinor–malor, përdorimi i kablllove ABC me vetëmbajtje është zgjidhja e vetme që siguron reduktim të humbjeve, rritje të sigurisë, përmirësim të cilësisë së tensionit dhe zvogëlim të defekteve të shkaktuara nga faktorë të jashtëm.

Investimi parashikon zëvendësimin e përçuesve ekzistues me seksione të zgjedhura ABC (4x25, 4x35, 4x50 ose sipas rastit në varesi të ngarkesës së zonës), shtrirje të re të linjave në trasa më të qëndrueshme, ndarje ngarkesash kur është e nevojshme, si dhe standardizim të daljes nga kabinat për të siguruar mbrojtje të plotë dhe funksionim optimal të rrjetit. Kablllo ABC përmirëson ndjeshëm nivelin e mbrojtjes ndaj kontaktit me pemët, ul riskun e ndërprerjeve dhe mundëson një profil më të qëndrueshëm të tensionit përgjatë gjithë daljes.

Në këtë mënyrë, rikonstruksioni me kablllo ABC paraqitet si i vetmi variant teknikisht i justifikueshëm dhe ekonomikisht i qëndrueshëm për zonat e prekura nga investimi, duke garantuar rritjen e besueshmërisë së rrjetit, minimizimin e avarive dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të konsumit.

Traseja e linjes do të jetë buze rruges nacionale me shtylla b/a

Shtyllat do të vendosen cdo 35-40 m dhe në këndet e saj, distance ndermejt shtyllave do të zvogelohet.

Në zbritjen e kabellit që do të furnizoje kabinat e reja dhe ekzistuese do të vendosen mbrojtje kabelli.

Vlera paraprake e këtij varianti 210,000,000 Lekë

Konkluzione:

Nga analiza e mesiperme arrijme në konkluzionin se duke gjykuar rëndësinë që ka kjo linjë për furnizimin e zonave Gjalish, Mallunxh, Prell, Shlli, Shqefen, Kurdari, Kete, Cruje, mendojmë se ky variant është me i përshtatshëm për tu zbatuar, për keto arsye:

- Parametrat teknike në linjat kablllore janë me të mire.
- Kushtet teknike të sigurisë teknike plotësohen në maksimum
- Ndikimi në mjedis është 0
- Jetëgjatësia e linjes kablllore është me të madhe

Nisur nga konkluzioni i variantit të perzgjedhur do të pasqyrojmë të dhënat kryesore për linjen e re që do të zhvillohet

Emri i plote i OBJEKTIT të investimit:

“5. Rikonstruksion i rrjetit TM-TU për fiderat Ngjeqar, Roskovec 3, Strum 4, NSt. Matke 35-10 kV”

Ky investim konsiston në rikonstruksion të linjes TM, kabinave elektrike dhe rrjetit TU me kabllo me vete mbajtje ABC.

Seksioni i perzgjedhur i kabullit ABC do të jetë në varesë në ngarkesë të lidhur në atë segment të linjes TU.

- Të dhënat e rrjetit të ri sipas projekt idesë

N/stacioni 35/6kV Pocem															
Fideri	Tensioni	Fuqia instaluar max.	Fuqia e gjeneruesve	Abonent		Linja TM				Nr. nderprerjeve	Kohe zgjatja (min)	Humbje teknike (kWh)	Humbje teknike %	Humbje jo teknike (kWh)	Humbje jo teknike %
						Linja	Gjatesi	Seksioni							
Nr.	(kV)	(kVA)	(kVA)	N/stacion	Fider	(model)	(km)	(mm ²)	Viti 2025	Viti 2025					
Fratar	6	5,448	0	Pocem	1,631	Ajrore	66.7	Al-Ç 50-25	153	102	19713	97749	24%	N/A	N/A
Kute	6	2,485	0	Pocem	580	Ajrore	22.6	Al-Ç 35-16	151	78	14181	35064	17%	N/A	N/A
Pocem	6	520	0	Pocem	21	Ajrore	1.1	Al-Ç 50-25	62	15	256	7758	15%	N/A	N/A
Klos	6	3,295	0	Pocem	582	Ajrore	18.1	Al-Ç 35	140	65	864	45629	25%	N/A	N/A
Freskia	6	430	0	Pocem	45	Ajrore	0.55	Al-Ç 35-25	57	12	150	1335	5%	N/A	N/A
Totali	6	12.178	0	Pocem	2.859	Ajrore	109.05					187535	17%		

- Kabina të reja

Në këtë investim nuk janë parashikuar investime të reja. Rrjetit ekzistues do ti bëhet rikonstruksion total.

- Skema elektrike e fiderave

Skemat e fiderave do të mbeten të pa ndryshueshme

- Linja TU për kabinat që shtohen në fidera

Në këtë investim nuk janë parashikuar kabina të reja, si e tillë këtij rrjetit ekzistues TU do të ndërtohet për kabinat ekzistuese.

Emri Kabinës	Gjatesia ne km	Lloji I linjes TM	Seksioni I percjelle sve	Fuqia e instaluar kVA	Nr. I transfor matoreve e ne kabine	Tipi I kabines	ABC 95 mm ²	ABC 70 mm ²	ABC 50 mm ²	ABC 35 mm ²	ABC 25 mm ²	ABC 16 mm ²	Sasia Totale
Fideri Suk													
Jagodine 3	0.4	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Jagodine 1	0.4	Ajrore AL	70	250	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 1-1	0.4	Ajrore AL	35	560	1	Murature	225	315	320	270	180	180	1490
Suk 1-2	0.8	Ajrore AL	35	100	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Suk 1-6	0.2	Ajrore AL	25	50	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 1-4	0.3	Ajrore AL	35	100	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Maternitet(Suku 4)	0.14	Ajrore AL	70	250	1	Murature	225	315	320	270	180	180	1490
Suk 2-5	0.56	Ajrore AL	70	250	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 2/4	0.63	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 2/6	0.21	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Suk 2/3	0.1	Ajrore AL	70	180	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Suk 2/9	0.05	Ajrore AL	70	180	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Suk 2/1	0.1	Ajrore AL	70	320	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 2/2	0.15	Ajrore AL	70	400	1	Metalike	270	225	240	315	180	90	1320
Suk 2/7	0.6	Ajrore AL	25	50	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Arapaj 6	0.5	Ajrore AL	70	50	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Arapaj 1	0.56	Ajrore AL	70	100	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Arapaj 5	0.75	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
Arapaj 2	0.35	Ajrore AL	70	100	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Arapaj 3	0.95	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	270	225	240	315	180	90	1320
TOTALI	8.15			3440	20		4950	4500	4640	6030	3600	1980	25700

Emri Kabinës	Gjatesia ne km	Lloji I linjes TM	Seksioni I percjelles ve	Fuqia e instaluar kVA	Nr. I transfor matoreve ne kabine	Tipi I kabines	ABC 95 mm ²	ABC 70 mm ²	ABC 50 mm ²	ABC 35 mm ²	ABC 25 mm ²	ABC 16 mm ²	Sasia Totale
Fideri Ngjeqar													
Tomorraket	2.78	Ajrore AL	70	50	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 5	0.8	Ajrore AL	70	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 7	0.8	Ajrore AL	35	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 8	0.4	Ajrore AL	35	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 3	1.85	Ajrore AL	35	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 6	0.25	Ajrore AL	50	250	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 1	3	Ajrore AL	70	180	1	Kulle	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 9	0.6	Ajrore AL	50	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 4	0.35	Ajrore AL	50	180	1	Metalike	180	180	160	270	180	90	1060
Kurjan 2	1.6	Ajrore AL	35	100	1	kulle	180	180	160	270	180	90	1060
Mbers 3	0.34	Ajrore AL	25	50	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Vlosh 1	2.3	Ajrore AL	35	100	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Vlosh 2	0.96	Ajrore AL	25	160	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Vlosh 5	0.3	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Vloshi 6 (Sali Rerza)	1.4	Ajrore AL	25	50	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Vlosh 3	1.2	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 9	0.8	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 1	0.6	Ajrore AL	25	100	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 8	2.5	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 7	0.8	Ajrore AL	25	200	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 3	0.4	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 6	0.8	Ajrore AL	25	100	1	Murature	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 2	1.1	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 10	1.3	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Ngjeqar 4(Stani)	2.1	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Mbers 1	1.2	Ajrore AL	25	180	1	Metalike	180	180	160	270	180	90	1060
Mbers 2	0.96	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Çerven 1	0.4	Ajrore AL	25	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Mbers 4	1.55	Ajrore AL	35	100	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
Çerven 2	1.7	Ajrore AL	35	150	1	Shtyllore	180	180	160	270	180	90	1060
TOTALI	35.14			3450	30		5490	5445	4880	8145	5400	2700	32060

Emri Kabinës	Gjatesia ne km	Lloji i linjes TM	Seksioni i percejeljes ve	Fuqia e instaluar kVA	Nr. I transfor matoreve ne kabine	Tipi I kabines	ABC 95 mm ²	ABC 70 mm ²	ABC 50 mm ²	ABC 35 mm ²	ABC 25 mm ²	ABC 16 mm ²	Sasia Totale
Fideri 4 Strum													
Strum 12	0.1	Shtyllore	35	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 4	1.05	Murature	70	100	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Strum 2	0.2	Murature	25	180	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Strum 9	0.2	Shtyllore	25	50	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 6	0.9	Shtyllore	35	180	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 5	0.63	Shtyllore	25	250	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 1	0.75	Murature	25	615	1	Murature	270	225	240	315	180	90	1320
Strum 3	0.7	Metallike	25	100	1	Metallike	270	225	240	315	180	90	1320
Strum 7	0.8	Shtyllore	25	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 8	0.6	Shtyllore	25	250	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Strum 11	0.4	Shtyllore	25	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 8	0.4	Shtyllore	25	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 3	0.4	Shtyllore	25	180	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 2	0.5	Murature	25	315	1	Murature	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 1	0.4	Murature	25	250	1	Murature	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 4	0.4	Shtyllore	25	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 6	0.5	Shtyllore	25	100	1	Shtyllore	180	225	200	270	180	90	1145
Velmish 9	0.15	Murature	35	250	1	Murature	180	225	200	270	180	90	1145
TOTALI	9.08			3320	18		3600	4050	3760	5040	3240	1620	21310

Buxheti qe parashikohet

Ky projekte parashikohet te kete baze materiale kryesore

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Rikonstruksion Rrjeti TM	km	52.37
2	Rikonstruksioni i kabinave elektrike	copë	68
3	Rikonstruksion rrjeti TU	km	79070

Nga perlllogaritja e sasive nga lista e manualit te cmimeve vlera e projektit mund te arrije ne vleren e perafert prej **130,000,000 lek.**

Projekti i Zbatimit duhet te paraqitet

Cdo vizatim do të ketë stampën në pjesën e poshtme në krahun e djathtë me informacionet minimale si mëposhtme (modeli standart):

- Emrin e Investitorit
- Emrin e projektit
- Emrin e vendit ku punohet
- Numrin e vizatimit
- Përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së vizatimit
- Emrin e projektuesit
- Shkallen e vizatimit (në rastet kur aplikohet)

Veriu duhet të tregohet në të gjitha vizatimet e hartave e planimetrive. Planimetritë do të jenë në shkallë 1:1000. Detajet e Instalimit 1:50.

SPECIFIKIMET E MATERIALEVE

Të gjitha materialet që do te përdoren në realizimin e projektit duhet të jenë në përputhje me standartet dhe specifikimet e OSSH sh.a.

Kabinat e reja BOX që do të ndërtohen do të jenë sipas standarteve të OSSH sh.a.

Lyerja e tyre të bazohet në standartet e kompanisë dhe ngjyra sipas kodit përkatës #FFD366.

KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT

Gjatë hartimit të projektit te shmangen zonat e mbrojtura natyrore dhe historike. Gjatë hartimit të projektit të bashkepunohet me Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit në DPSMM me qëllim minimizimin e efekteve negative të realizimit të projektit në mjedis dhe të efekteve sociale

Kerkesat ambientale:

- Temperatura Max. e ambientit + 40⁰C
- Temperatura Min. e ambientit - 20⁰C
- Temperatura Max. mesatare + 30⁰C
- Temperatura mesatare vjetore ne ajer + 15⁰C
- Lageshtia Relative Max. 80 %
- Shpejtesia Max. e eres 130 km/h
- Lartesia Max. nga niveli detit 1000 m

Parametrat e rrjetit TU:

- Tensioni nominal i sistemit 230/400 V
- Tensioni më i lartë i sistemit 0.66 kV
- Numri i fazave 3
- Frekuenca 50 Hz
- Sistemi i tokezimit i lidhur direkt ne toke

Parametrat e rrjetit 10 kV:

- Tensioni nominal i sistemit 10 kV
- Tensioni më i lartë i sistemit 12 kV
- Numri i fazave 3
- Frekuenca 50 Hz
- Sistemi i tokezimit i izoluar
- Qendrueshmeria ndaj LSH
 - o Nenstacionet Primare 40 kA (3s)
 - o Kabinat Shperndarese 25 kA (1s)

Distanca minimale e izolimit: 25 mm/kV

1. Dokumentacioni per Projekt-Zbatimin

Nga grupi i projektimit të hartohet minimalisht dokumentacioni i më poshtëm:

1. Relacion teknik.
Ky relacion duhet të ketë karakter shpjegues dhe duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:
2. Parimet baze ku grupi është mbështetur në realizimin e projektit,
3. Përshkrim të gjendjes ekzistuese së rrejtës në zonë
4. Përshkrim të projektit të ri
5. Rezultatet e llogaritjeve
6. Vizatimet dhe detaje
7. Preventivi, përcaktimi i kostove të projektit sipas vkm
8. Specifikimet teknike.

Dokumentacioni te përgatitet ne formatin elektronik dhe i printuar si më poshtë:

1. Relacioni teknik, të printohet në 3 kopje në formatin A4 ndërsa pjesë të vecanta mund të printohen dhe formatin A3
2. Vizatimet dhe Detaje, në PDF dhe të siglohen elektronikisht nga grupi projektimi. Formatin i printimit sipas formatit, gjithashtu në materialin e dorëzuar vizatimet dhe detajet duhet të jenë dhe në formatin elektronik DWG
3. Preventivi i objektit. Te printohet ne formatin A4 ne 3 kopje. Gjithashtu duhet të përgatitet në formatin pdf për prokurim (pa cmime) dhe në formatin PDF identike sikurse është printuar në hard copy i sigluar elektronikisht nga grupi projektimi si dhe në formatin elektronik.
4. Specifikimet teknike. Duhet të jene pjesë e projektit vetëm në formatin PDF

I gjithë dokumentacioni elektronik i shprehur me siper te jepet ne CD dhe te jete i grupuar ne 3 foldera te vecante:

1. Materialet elektronike ne format Word, Excel, DWG etj. Varianti perfundimtare i tyre në këtë folder duhet të përfshihen:
 - a. Relacioni teknik (ëord)
 - b. Vizatimet dhe Detaje (DWG)
 - c. Preventivi i objektit (Excel)
 - d. Specifikimet teknike (PDF)
2. Materialet elektronike në format PDF për prokurim
 - a. Relacioni teknik (PDF – pa emrat e grupit te projektimit)
 - b. Vizatimet dhe Detaje (PDF – pa emrat e grupit te projektimit)
 - c. Preventivi i objektit (PDF – pa emrat e grupit te projektimit dhe pa cmime, vetëm me volume)
 - d. Specifikimet teknike (PDF)
3. Materiale elektronike në PDF të sigluara nga grupi projektimit
 - a. Relacioni teknik (PDF – me emrat e grupit të projektimit dhe i sigluar elektronikisht)

- b. Vizatimet dhe Detaje (PDF – me emrat e grupit te projektimit dhe i sigluar elektronikisht)
- c. Preventivi i objektit (PDF – me emrat e grupit të projektimit dhe me cmime dhe i sigluar elektronikisht) (Specifikimet teknike PDF)

Grupi i hartimit te Relacionit

Ing

Aprovoi

K/Ing

Miratoi

Drejtori